

Jeton Neziraj, shkrimtar, dramaturg dhe skenarist, një nga themeluesit e Qendrës Multimedia

Jashtë qendrave, heteropatriarkia ende sundon me një grusht të hekurt

Duke besuar se teatri po përpiqet të gjejë një aleat atje ku ai nuk ekziston, me synim për të prekur publikun e parehatshëm, Jeton Neziraj, shkrimtar, dramaturg dhe skenarist Kosovar është një nga themeluesit e Qendrës Multimedia, një nga projektet më interesante dhe më të rëndësishme kulturore rajonale të fokusuara në teatër dhe letërsi.

Pas shfaqjes jashtëzakonisht të suksesshme "55 Shades of Gay", Qendra Multimedia aktualisht është duke shfaqur "Balkan Bordello" - një projekt transatlantik në të cilin marrin pjesë edhe teatrat La MaMa nga Nju Jorku dhe Atelje 212 nga Beogradi. Pas turnesë në Kosovë, Shqipëri dhe Serbi, shfaqja do të mbahet në Nju Jork në prill të vitit të ardhshëm.

Për portalin tonë ai foli për mungesën e kureshtjes për tjetrin, e cila është një pengesë më e madhe sesa pengesa gjuhësore, për poshtërsinë e politikës që prodhoi idenë e vizave reciproke midis Kosovës dhe Bosnje -Hercegovinës, për njerëz që e mbajnë komunikimin në Ballkan gjallë dhe sa është e rëndësishme që njerëzit personalisht ta prekin realitetin dhe jo të kenë ndërmjetësues.

Vitin e ardhshëm do bëhen 20 vjetë nga themelimi i Qendrës Multimedia. Bëhet fjalë për një stazh serioz dhe për vende më serioze sesa ato të Ballkanit. Keni arritur që vite me rradhë të profiloheni si një nga projektet kulturore më interesante dhe më të rëndësishme të fokusuara në letërsinë dhe teatrin modern. A është Qendra Multimedia e vetmja mënyrë e veprimit për dikë me një botkuptim siç e keni ju, për një njeri që nuk i përkushtohet artit kombëtar por artit pa asnjë shenjë, artit të lirisë dhe të krijimit në liri.

Në të vërtetë, ju tani po ma kujtoni që po, vitin e ardhshëm bëhen 20 vite që kur është themeluar Qendra Multimedia. Dhe nuk janë vetëm vite të thata, numra, por janë vite punë aktive dhe angazhim në një teren jo fort të kollajshëm. Qendra ka qenë një platformë që na ka mundësuar të rritemi plot neve artistëve të teatrit në Kosovë dhe në të njëjtën kohë, ka qenë (dhe ngelet akoma) njëllon hapësirë 'eksterritoriale' e lirisë artistike, e asaj lirisë që ka munguar në institucioneve publike, që ka munguar, praktikisht, gjithkund tjetër në sferën publike. Por gjërat ndërkohë kanë ndryshuar për të mirë. Këto 'hapësira lirie', përgjatë këtyre viteve, kanë ardhur duke u zgjeruar në Kosovë dhe ato tashmë janë shtrirë edhe në institucionet publike. Jo gjithmonë, fatkeqësisht, por këto vite të fundit, gjithnjë e më shpesh, ndodhë që në institucione publike të vijnë njerëz kompetent, të vetëdijshëm se teatri nuk duhet t'i shërbej pushtetit. Pra, janë njerëz që teatrin e shohin si teatër, ose nëse do ta parafrazonim Gertrude Stein-in, do të thonim se besojnë që 'teatri është teatër është teatër'. Pra, jo arenë masturbimesh nacionaliste, jo megafon i qeverisë, jo vend për të shfryrë frustrimet nacionale, jo vend për të mbjellur urrejtje. Përkundrazi, ata besojnë në teatrin si një forum që, duke qenë kritik, e ndihmon shoqërinë të zhvillohet, të ecë përpara dhe të prosperoj. Por në anën tjetër, kjo gjendje optimizmi mund të përmbysset shpejtë. Sepse, gjithmonë

mund të vijnë në pushtet garnituara politikanësh të cilët artistët e shkrimtarët i shohin si agjent të 'fotoshopeve nacionale' që duhet të përmirësojnë 'defektet' dhe 'shkarjet e shoqërisë'. Sic në fakt po ndodhë këto vitet e fundit në Serbi, ku ajo shoqëri civile dhe ajo skenë e pavarur artistike e para ca vitesh, që ishte e gjallë dhe vibrante, tani është tkurrur dhe gati nuk ekziston. Sepse është përmbysur nga politika aktuale. Dhe në këso raste, po, streha e vetme për disa artistë që rezistojnë dhe që s'duan të nënshtrohen ngelen strukturat si Qendra Multimedia në Prishtinë, ose si Qendra për Dekontaminim Kulturor apo Asociacioni Krokodil në Beograd.

TË GUXIMSHËM APO BUDALLENJË NË FILLIM TË FESTIVALIT POLIP

Me pasojat e mëdha që pandemia COVID pati në kulturë edhe në mbarë botën, veçanërisht në vendet tona të vogla, Qendra Multimedia mbeti pa hapësirë vitin e kaluar, e cila ishte në pronësi private dhe pronari vendosi ta shiste atë. Përveç të gjitha sfidave të ndryshme që ekzistojnë, si i përballoni ato që kanë të bëjnë më mungesen e çatisë mbi kokë, si e zgjidhni këtë problem dhe a paraqet mungesa e hapësirës fizike në fakt një problem për ju, duke marrë parasysh natyrën e juaj nomade, veçanërisht për faktin se Festivali Polip, një nga programet tuaja më të rëndësishëm, u krijua në hapësirat publike, siç janë kafenetë?

Hapësira që posedonim për gati 10 vite, na shërbente kryesisht për prova të shfaqjeve, për organizime letrare, performanca e evente të vogla. Dhe ajo ishte një zgjidhje, jo e duhura, por e pranueshme për rrethanat e një kryeqyteti që ka kallxuar deri edhe armiqësi ndaj skenës së pavarur kulturore. Ëndërra jonë shumëvjeçare ishte të gjenim një hapësirë më të dinjitetshme dhe atë ta kthenim në teatër. Megjithatë, vjet, edhe atë pak hapësirë që kishim e humbëm. Por, kjo gjë na mobilizoi të shihnim alternativa të tjera. Dhe alternativa u gjet shpejtë. Ndërkohë, që ne kishim humbur hapësirën tonë, teatri Oda në Prishtinë, i vetmi teatër i pavarur, ishte goditur nga kriza financiare. Ata ishin në cep të ekzistencës. Dhe prandaj, nevoja dhe kriza na bashkoi. Kështu që, nga viti i kaluar po e bashkë-ndajmë hapësirën e teatrit Oda. Tani jemi aty, e komuna e Prishtinës ka vedosur ta marrë përsipër qiranë dhe komunalitë tjera dhe kjo është një lloj lehtësimi për ne. Megjithatë, ai teatër është në gjendje të mjerueshme infrastrukture. Është një ambient pune jo fort i dinjitetshëm. Tani po i presim investimet e komunës për ta renovuar – shpresojmë të ndodhin gjatë vitit 2022. Gjërat duket se kanë filluar të lëvizin pozitivisht në atë drejtim.

Ndërkohë, ne po vazhdojmë me aktivitet tona. Tani aktualisht aty jemi duke e realizuar shfaqjen "Balkan Bordello", një projekt trans-atlantik i teatrit La MaMa nga Nju Jorku, Qendrës Multimedia nga Prishtina dhe teatrit Atelje 212 nga Beogradi. Pas turnesë në Kosovë, Shqipëri e Serbi, shfaqja në Prill të vitit të ardhshëm do të jepet në Nju Jork, në teatrin La MaMa.

Me pak fjalë, Polipi i është përkushtuar afrimit të letërsisë Kosovare me atë Serbe. Si i shikoni fillimet e tij sot, sa energji dhe entuziazëm duheshin për krijimin dhe mbijetesën e tij një dekadëshe?

Në fakt, jo afrimit të letërsisë kosovare me atë serbe, por festivali ishte nisur që ta mundësonte shkëmbimin e letërsisë dhe të shkrimtarëve, ndërmjet dy shoqërive të traumatizuara nga e kaluara armiqësore. Njohja dhe komunikimi ishin dhe ngelen imperativ. Komunikimi kulturor, para së gjithash.

Por këto vitet e fundit, festivali 'polip' nga një festival që kishte në fokus rajonin, është shëndërruar në një festival të vërtetë ndërkombëtar të letërsisë, e ku, vec leximeve, debatohen edhe tema e probleme të ndryshme politike e sociale me karakter evropian e përtej. Kjo lloj zhvendosje nuk do të thotë se rajoni është 'shëruar' dhe se festivali tashmë e ka mbaruar punën e vet. Natyrisht jo. Por nëse në fillim festivali ka projektuar një lloj vizioni për shoqëritë tona që duhet të bashkëjetojnë, ne tani këtë vizion po përpiqemi ta vendosim në një kontekst më të gjerë; pra, të një bashkëjetese në një Evropë të bashkuar. E di, tingëllon shumë poetike kjo!

Megjithatë, që t'i kthehem pyetjes! Për këto 11 edicione, polip- Festivali Ndërkombëtar i Letërsisë ka bërë jashtëzakonisht shumë, në disa drejtime, duke përfshirë edhe promovimin e dhjetra autorëve të rinjë. Fillimi natyrisht ka qenë tjetër, ka ndodhur në rrethana krejt tjera, në rrethana të një frike, por edhe të një kryeneqësie se gjërat duheshin lëvizur. Në edicionin e parë, në vitin 2009, ishte hera e parë pas lufte që shkrimtarë serbë po lexonin publikisht në Prishtinë. Ne ishim ose të guximshëm ose budallenjë.

Por gjërat tani kan ndryshuar për të mirë. Është një ndryshim i prekshëm. Dhe ai ndryshim nuk ka prekur vetëm publikun, por na ka prekur edhe neve, individualisht. Sasha Ilic, që është edhe njëri nga drejtorët artistik të festivalit (bashk me Alida Bremerin nga Kroacia dhe me mua) tani është njëri nga miqt e mi më të mirë që kam.

ËSHTË JASHTËZAKONISHT E RËNDËSISHME QË NJERËZIT TA PREKIN REALITETIN VETË DHE JO TË KENE NDËRMJETËSUES

- **Për shtatë vitet e fundit, Qendra Multimedia po zbaton një program rezidencash për shkrimtarët që quhet Prishtina has no river ("Prishtina nuk ka lum"), falë të cilave ju jeni nikoqirë të autorëve të profileve të ndryshme nga Evropa Qendrore dhe Juglindore dhe Gjermania. Deri në çfarë mase ky program i ka ndihmuar mysafirët nga Evropa Juglindore në veçanti që të krijojnë një pamje të saktë për Kosovën, të pangarkuar nga informacionet e paplota të viteve 1980 dhe 1990?**

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që njerëzit ta prekin realitetin vet dhe jo të kenë ndërmjetësues – pra, as mediat, madje, sidomos jo mediat, të cilat sic e dijmë, kan shpesh një dioptri goxha të mjegulluar. Ta zëmë, për tabloidet e sëmura në Serbi, shqiptarët në Kosovë vazhdojnë të enden me bomba në duar, për të rrënuar ndonjë manastir ose për t'ia hedhur në ajër shtëpinë ndonjë serbi të shkretë. Por, realiteti, fatmirësisht është krejtësisht i kundërt. Prandaj, përballja e shkrimtarëve me realitetin ofron një dimension tjetër, të një realiteti që është me më shumë ngjyra e dritë-hije. Dhe atë realitet shkrimtarët e përtypin në mënyrën e vet dhe vet i nxjerrin konkluzionet, pa pasur nevojë për ndërmjetësues.

- **Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova ndajnë një përvojë të ngjashme të organizimit të paradave të krenarisë në një kohë kur ato janë pjesë e një tradite në pjesët më progresive të ish -shtetit të**

përbashkët. Pavarësisht nga kjo vonesë, ka hapa të tillë si reagime pozitive ndaj shfaqjes suaj "55 Shades of Gay", e para që i kushtohet çështjeve LGBT në Kosovë. Si i shihni ndryshimet që po ndodhin në Ballkan, i cili është thellësisht heteropatriarkal dhe lidhet me të drejtat e komunitetit LGBT, dhe a janë njerëzit që i përkasin komunitetit LGBT ata që në të vërtetë nuk i kushtojnë asnjë rëndësi kufijve që politika përpiqet ti imponoj?

Sa u përket çështjeve në lidhje me komunitetin LGBTIQ+, fatmirësisht, gjërat kanë filluar të ndryshojnë rrënjësisht, të ndryshojnë për të mirë. Ka pasur këto dy tri vitet e fundit një numër të performancave teatrore, janë realizuar disa filma, janë organizuar evente të ndryshme publike, botime të librave, janë organizuar pa incidente gay paradat, komuniteti LGBTIQ+ ka filluar të komunikojë bashkëpunoj në nivel rajonal e kështu me radhë... Në përgjithësi, në sferën publike sot flitet e diskutohet shumë më shumë për komunitetin LGBTIQ+, sesa, ta zëmë, para tri ose katër vitesh.

Krejt këto lëvizje, përpos që dëshmojnë një kulturë të pasur LGBTIQ+ në rajon, poashtu janë shenjë e një emancipimi të përgjithshëm shoqëror që po ndodhë në këto anë. Natyrisht, duhet ta potencojmë se ndryshimi po ndodhë kryesisht në qendrat kryesore urbane, ndërkohë që provincat janë thuaja të paprekuara nga ky zhvillim. Jashtë qendrave, heteropatriarkali vazhdon të sundojë me grusht të hekurt. Prandaj, në këtë drejtim ka akoma shumë punë për të bërë, nga të gjithë ne. Sidomos nga ne artistët, sepse besoj që një vepër arti, një shfaqje teatri, ta zëmë, mund të ketë impakt shumë më të fuqishëm, se që mund të kenë dhjetra seminare, trajnime e ligjërata të thata. Dhe përpos që na duhet më shumë shfaqje teatri me tematikë LGBTIQ+, ato duhet edhe të kenë qasje të sinqert, duhet të pasqyrojnë realitetin homofob të shoqërive tona, të pasqyrojnë jetën plot ngjyra të pjestarëve LGBTIQ+, të pasqyrojnë dramën e sfidat me të cilat pjestarët LGBTIQ+ ballafaqen, e kështu me radhë.

Në shfaqjen tonë "55 Shades of Gay" që ju e përmendët, ne përpos që denoncojmë shoqërinë homophobe, denoncojmë dhe tallemi edhe me grupe të caktuara, si ta zëmë, me një grusht të ashtucajturisht intelektual shqiptar, nënshkruar të një peticioni anti LGBTIQ+, denoncojmë dhe kthehjmë vëmendjen edhe kah njerëzit që përdorin religjionin për të mbjellë urrejtje ndaj personave LGBTIQ+, por në anën tjetër, kritikojmë edhe ngathtësinë e komunitetit LGBTIQ+ për t'u organizuar.

TEATRI DUHET TA KËRKOJ DHE TË SHKOJ TEK PUBLIKU I "PAREHATSHËM"

- **Ju keni qenë pioner i bashkëpunimit kulturor me Beogradin në kohën kur ishit drejtor artistik i Teatrit Kombëtar në Prishtinë, diçka që nuk është parë gjithmonë në mënyrë të favorshme në mjedisin tuaj, dhe nuk ishit të mirëpritur kudo që keni shkuar. Çfare mund të thoni nga përvoja personale sot për artin si një faktor integruar midis kombeve?**

Disi, gati përherë kam pasur problem me përkufizimet e tipit "arti si mjet pajtimi". Shkëmbimet kulturore mes Kosovës e Serbisë të cilat i kemi inicuar përmes Qendrës Multimedia, bashkëpunimet e ndryshme në të cilat unë kam qenë i përfshirë, nuk kanë pasur si qëllim në vete 'pajtimin' ose 'integrimin', jo, sepse atëherë ne s'do t'kishim qenë artist, por aktivist të paqes. Natyrisht, kemi qenë të vetëdijshëm se konteksti politik i Kosovës dhe Serbisë do të mundësojë gjenerimin edhe të disa përfitimeve 'anësore',

duke përfshirë shembjen e paragjytimeve e stereotipeve, shtendosjen e raporteve e përgjithësisht krijimin e një normaliteti në raportet shqiptaro-serbe.

Por që ta përsëris: ky është një “përfitim anësor” të cilin e mundëson konteksti politik. Një “Romeo e Julieta” që realizohet me aktorë serb e shqiptarë ka tjetër imazh dhe tjetër ‘lexim’ politik nga një “Romeo e Juliet” që realizohet vetëm me aktorë shqiptar në Prishtinë apo vetëm me aktorë serb në Beograd. Se sic do të thoshte Marina Abramovic “konteksti çon peshë”. Rrjedhimisht, teatri shkon dhe përpiqet të gjej aleat aty ku nuk ka aleat, ai s’ka shumë cka t’u thotë të ‘konvertuarve’. Një shfaqje për LGBTIQ+ merr kuptim kur shfaqet jo më për komunitetin LGBTIQ+, por për të tjerët, veçanërisht për homofobët. Prandaj teatri duhet ta kërkoj dhe të shkoj tek publiku “i paretshëm”, tek ai publik që nuk ndihet komod me atë që po i shfaqet. Dhe prandaj, këto vitet e fundit, ne kemi realizuar disa projekte teatrore me artist nga Serbia, kemi shkëmbyer e vazhdojmë të shkëmbejmë shfaqjet tona. Sepse teatri politik që ne praktikojmë fiton më shumë peshë dhe ka më shumë kuptim i vendosur në kontekstin e acarimit dhe konfliktit të vazhdueshëm shqiptaro-serb.

MUNGESA E KURRESHTJES PËR TI NJOHUR TË TJERËT ËSHTË BARRIERË MË E MADHE SESA BARRIERA GJUHËSORE

Përveç të gjitha sfidave me të cilat ballafaqohemi në vendin tuaj, sa ju frustron fakti që kultura e Kosovës nuk komunikon me pjesën tjetër të rajonit ashtu siç komunikojnë Zagrebi dhe Sarajeva apo Sarajeva dhe Beogradi, duke rrespektuar pengesat objektive siç është gjuha, kur bëhet fjalë për letërsinë bashkëkohore, e cila pastaj duhet të përfshijë edhe përkthimin, së bashku me ato pengesa të tjera joobjektive me natyrë politike, duke përfshirë edhe regjimin e vizave për njerëzit nga Kosova që i bën shumë gjëra të pamundura dhe të pakuptimta.

Natyrisht, barrierat gjuhësore janë aty, por ato nuk janë dhe nuk do të duhej të ishin pengesat kryesore për qarkullimin e letërsisë e as të teatrit. Ajo që është më shqetësuese është mungesa e kureshtjes, respektivisht mungesa e interesimit për ta njohur letërsinë që shkruhet pas atyre drunjëve, pas asaj fushe a kodre, pra, letërsinë e fqinjëve, teatrin që krijojnë të tjerët afër neshë. Prandaj, mungesa e kureshtjes për tjetrin është barrierë më e madhe sesa barrierë gjuhësore.

Ta zëmë, me shfaqjet tona të Qendrës Multimedia kemi luajtur gjithandej në Evropë, por kurr nuk kemi qenë në Sarajevë. Ose, cka nëse themi se, përgjatë ndoshta këtyre mbi 50 vitesh (në mos më shumë) kurr një shfaqje e Kosovës nuk është shfaqur në ndonjë teatër në Mal të Zi, në Podgoricë apo Cetinjë! Dhe po, për budallenjtë, le ta konfirmojmë: Mali i Zi dhe Kosova janë vende fqinje.

Dhe pastaj mund të flasim edhe për vizat. A e dini sa i turpëruar ndihem që Dino Mustafiç nuk mund të vij në Kosovë, sepse i duhet vizë, marrja e së cilës kërkon një mal përpjekjesh administrative, duke përfshirë edhe një udhëtim në Shkup. Ja, pikërisht këtyre ditëve kemi ftuar Haris Pashoviçin në Kosovë dhe jam aq shumë i turpëruar që me sa duket ardhja e tij do të jetë e pamundur, shkak i vizave. Vërtetë,

nuk di gjë më të poshtër që politika ka mundur të pjellë, sesa ideja e vizave të ndërsjellta, mes Kosovës e Bosnjës. Është akt barbar, anticivilizues. Nuk mund ta merrni me mend sesa i mllëfosur që jam. Dhe nuk dua t'ia di për asnjë argument që i justifikon vizat. Kushdo që përpqiet ta argumentoj këtë gjë është një hajvan.

Në një intervistë, ju thatë se ndonjëherë 15 persona janë të mjaftueshëm për të mbajtur gjallë komunikimin. Kush janë ata në nivelin rajonal që e bënë këtë komunikim më të gjallë, domethënë kush janë njerëzit, parimet njerëzore dhe botëkuptimet artistike që përputhen me ato tuaja, pavarësisht se nga vijnë? Supozoj se mes tyre është sigurisht e ndjera Borka Pavićević, falë së cilës CZKD ka qenë gjithmonë e hapur për vizitat tuaja.

Natyrisht, Borka. Ajo qysh në fillim të 90-tave krijoi në Beograd Qendrën për Dekontaminim Kulturor (CZKD), një bastion kulturor e intelektual që i kundërvihet nacionalizmit serb dhe që përpqiej të frenonte ethet e luftës që kishin kapluar serbinë e asaj periudhe. E kam thënë vazhdimisht, CZKD e Borkës për krejt këto vite ka qenë njëllëj ambassade kulturore e munguar e Kosovës në Beograd. Borka, deri në vdekjen e sajë në vitin 2019 ishte një luftëtare e denjë e të drejtave të njeriut, një zë i fuqishëm opozitar, progresiste dhe e hapur ndaj bashkëpunimeve kulturore mes shteteve të krijuara pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Pas vdekjes së sajë, filozofi i mirënjohur Boris Buden me të drejtë do të shkruante se jeta e Borkës ka pasur kuptim politik. “Akush nuk mund të kundërshtoj që jeta e Borka Pavićevićit ka pasur kuptim politik. Shumë madje, pajtohen që ai kuptim nuk mund të reduktohet në figurën e aktivistes së vetmuar kulturore nga margjinat shoqërore, e cila heroikisht i reziston pushteteve jodemokratike dhe shumicës që e mbështetë atë pushtet.”, thotë ai.

Pos Borka Pavićevićit ka pasur dhe ka natyrisht edhe shumë artist e intelektual serbë të tjerë që kanë pasur dhe kanë pozicione e qëndrime të qarta ndaj të kaluarës, ndaj rolit të Serbisë në luftërat e viteve 90-ta e ndaj Millosheviqit, mes atyre, duhet patjetër të përmendim edhe Vladimir Arsenijević, shkrimtar dhe themelues i festivalit “Krokodil” në Beograd, Biljana Srbljanović, dramaturge e njohur dhe aktiviste e pashoq e të drejtave të njeriut, Tomislav Marković, poet dhe gazetar i pakompromis, Sasha Iliq, shkrimtar, i urreyer nga regjimi autoritar në Beograd për shkak se është njëri ndër promotorët e bashkëpunimit kulturor Kosovë-Serbi, Zlatko Paković, gazetar e regjisor i guximshëm, Millosh Zhivanović, poet i shkëlqyeshëm anti-qeveritar, e shumë e shumë të tjerë.

Ka natyrisht, profile si këta në Serbi edhe në Kroaci, Kosovë, Mal të Zi e Bosnjë e Hercegovinë... Nga Dino Mustafiq, Andrej Nikolaidis, Shkelzen Maliqi, Alban Ukaj, Haris Pasovic, Tanja Shljivar, Selma Spahiq, Arben Idrizi, Alida Bremer, Oliver Friliq... Këta dhe plot të tjerë, janë ata deminuesit kulturor, që shkulin minat të cilat kanë ngelur trashëgim nga e kaluara fashiste e rajonit, por që edhe pastrojnë të tanishmen nga kontaminimi nacionalist.